

# Autentifikimi i nënshkrimit

## Përshkrimi

Vërtetimi i autenticitetit të nënshkrimit të dokumentit të lëshuar nga funksionarë autoritetet shqiptare apo autoritetet e vendit në juridiksionin që mbulon përfaqësia diplomatike apo konsullore, si dhe autentifikimi i nënshkrimit të shtetasve.

## Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Një dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike;
- 2) Dokumenti origjinal i nënshkruar;

## Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht e personit të interesuar para konsullit ku bëhet verifikimi i identitetit të tij;
- 2) Dorëzimi i mandat-pagesës origjinale të tarifës, që ka derdhur në numrin e llogarisë së përfaqësisë diplomatike ose konsullore të RSH;
- 3) Kontrolli nga konsulli i nënshkrimit të dokumentit;
- 4) Vërtetimi i autenticitetit të nënshkrimit pasi është bindur që nënshkrimi është i rregullt;
- 5) Një kopje e dokumentit, pasi është vërtetuar autenticiteti i nënshkrimit dhe i është vendosur pulla taksë, mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës;

## Tarifa e shërbimit dhe afati

20 euro ose shuma ekuivalente në monedhën vendase.

Vërtetimi bëhet në momentin që paraqitet i interesuari.

## Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

## Shënime

Në rastet kur konsulli nuk është i bindur për vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasi, ai kryen procedurat e verifikimit të tyre nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme ose Institucioneve të vendit ku është lëshuar dokumenti.

Në vendet që nuk ka Ambasadë apo Konsullatë shqiptare, të interesuarit i drejtohen noterëve vendas. Për t'u njohur nga autoritetet në Shqipëri vërtetimet e noterëve vendas duhet të legalizohen ose apostilohen, si çdo dokument tjetër i huaj.